



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/398
Datë: 6/8/2021

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datë 13.7.2021 mori vendim që të shpallë:

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, për vitin akademik 2021-2022, në kuadër të projektit ERASMUS + "Iniciativa e Bujqësisë Urbane të Ballkanit Perëndimor "BUGI"

I. KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURSIT

1. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë për studimet master, për vitin akademik 2021-22, në kuadër të projektit ERASMUS + "Iniciativa e Bujqësisë Urbane të Ballkanit Perëndimor - BUGI", në përputhje me planprogramin e akredituar nga AKA do të regjistrojë **20** studentë në programin: **Bujqësi Urbane**.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin I të këtij konkursi duke u bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë do të regjistrojë deri në **12 %**, përkatësisht deri **2** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë.
3. Në studimet master në programin: **Bujqësi Urbane**, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet baçelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në Universitetin e Prishtinës.
4. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Në raste të tilla, kandidati duhet të sjellë dëshminë (vërtetim apo vendim) mbi akreditimin e institucionit në të cilin i ka mbaruar studimet paraprake. Në pamundësi të sigurimit të dëshmisë për akreditim, statusi i këtyre programeve do të konfirmohet nga zyra për zhvillim akademik e cila gjendet në Fakultetin Filozofik, kati II nr. 107.
5. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program tjetër studimi nga ai që aplikojnë, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër studimor. Në rast pranimi, Komisioni i Studimeve i njësishëm akademike cakton provime diferenciale të cilave duhet t'i nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Komisioni i Studimeve cakton numrin e provimeve varësisht nga shkalla e krahasueshmërisë / ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve diferenciale në afatin e qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë provime diferenciale të cilave do t'i nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësishëm akademike përkatëse. Në rast se brenda këtyre dy afateve kandidatët nuk arrijnë të kalojnë provimet diferenciale, atëherë humbin të drejtën për studim në atë program.
6. Përjashtim nga paragrafi 5 i pikës I të këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcakton vet njësia akademike.
7. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilin do nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
8. Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2021/22 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program studimor.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidateve do të bëhet sipas kritereve si në vijim:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në studimet themelore deri në 30 pikë;
 - Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.
2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
 3. Përveç provimeve nga lëndët profesionale, kandidatët do t'i nënshtrohen testit edhe në gjuhë angleze nga i cili mund të sigurojnë deri në 10 % të pikëve të provimit pranues. Nëse kandidati dëshmon që ka certifikatë ndërkombëtare TOEFL me së paku 79 pikë (ose IELTS me së paku 5.65 pikë), i njëjti me automatizëm merr 5 pikë, ndërsa pikët tjera lidhur me gjuhën angleze shtohen varësisht nga suksesi i treguar në provimin pranues - pjesën e gjuhës angleze.
 4. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40 % nga totali i numrit të pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
 5. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprake. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë femërore, përzgjedhja e kandidateve për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidateve me pikë të barabarta. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta. Sekretari i FBV-së është i obliguar që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgoj Rektoratit të Universitetit dhe ta publikoj në ueb-faqen e Fakultetit.
 6. Në qoftë se mbeten vende të lira në kategorinë e komunitetit jo shumicë, për arsye që një apo asnjë kandidatë nuk ka arritur që ta kalojë pragun minimal të pikëve për pranim, atëherë plotësimi i vendeve që i takojnë kësaj kategorie do të bëhet sipas ranglistës së pikëve, me kandidatët që e kanë kaluar pragun e kalueshmërisë dhe që i takojnë komunitetit shumicë.

III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> hapet prej datës **06.08.2021** deri më datë **24.08.2021** në ora 16.00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **06.08.2021**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **10:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **25.08.2021** deri më datë **28.08.2021**. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç 'regjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim fizik është si në vijim:**
 - a) *Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegëza (Linku) për aplikim online përmes Internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu> ;*
 - b) *Ekstrakti i lindjes (origjinal) jo më i vjetër se 6 muaj;*
 - c) *Diplomën origjinale, kopje të noterizuar ose dublikatë, përkatësisht certifikatën e diplomimit-origjinale;*
 - d) *Kopjen e letërnjoftimit;*
 - e) *Dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatët që kanë të mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës);*
 - f) *Kandidatët me rastin e aplikimit paguajnë 2.50 euro (fletëpagesa shkarkohet në web-faqe të UP-së me rastin e aplikimit).*
6. Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit të semestrit do të paguajnë tarifën e shkollimit sipas UA në

- fuqi.
7. Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit III, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli, t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.
 8. Të gjithë kandidatët janë të obliguar që të respektojnë rekomandimin e IKSHP për ruajtjen e distancës prej 1,5-2 metra dhe të përdorin maskën mbrojtëse.
 9. Nëse gjatë aplikimit online, kandidatët gabimisht kanë aplikuar në një program tjetër studimor, atëherë, duhet të kërkojnë nga zyrtari i IT të fakultetit përkatës që t'i fshihet aplikimi i gabuar nga sistemi në mënyrë që t'i mundësohet procedura e aplikimit nga fillimi. Kjo procedurë duhet të përfundoj para datës së mbylljes të aplikimit online.
 10. Dokumentet nën pikën c) mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmohen me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. *P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati, pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.*

Provimi pranues do të mbahet më datë 01.09.2021 në ora 14:00.

1. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të jenë të pajisur me maskë mbrojtëse (Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës) dhe me vete të posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

Ne kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE DHE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve preliminare e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakultetit më së voni deri më datën **02.09.2021** në ora **16.00**;
2. Me rastin e shpalljes së rezultatit preleminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, sepse pas ankesës dikush nga kandidatët mund të radhitet me lartë me pikë se kandidati i cili ishte radhitur sipas rezultatit preleminar.

V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preleminar renditen si kandidatë të pa pranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare (llogariten ditët e punës), respektivisht më së voni deri më datë **04.09.2021** në ora **16.00**.
2. Pas afatit të përcaktuar si në pikën e sipërshënuar, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet menjëherë pas mbylljes së afatit ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.
3. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **08.09.2021 -10.09.2021 (3 ditë pune)**.

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakultetit, pas shqyrtimit të ankesave, bazuar në datën e mbajtjes së provimit pranues dhe atë më së voni deri më datën **05.09.2021, pas orës 17:00**

VII. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. Regjistrimi dhe fotografimi i kandidatëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të

Universitetit (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), më datë **07.09.2021**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00 - 15:00**.

2. **Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **15.09.2021, në ora 15:00**. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen.**
3. Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.
4. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar nuk i përfillë të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.

VII. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

1. **Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:**
 - a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet dhe shtypet (bardh e zi) nga faqja <http://apliko.uni-pr.edu>
 - b) Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale;
 - c) Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga ueb faqja e Universitetit të Prishtinës) në shumën prej 150 € për një semestër. Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste të Kosovës;
 - d) Për informata të tjera të nevojshme, kandidatët mund t'i drejtohen FBV-së ose të kërkojnë informata në faqen zyrtare të UP-së www.uni-pr.edu.

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **20** studentë në programin si në vijim:

Departamenti – Programi studimor	Për studime të rregullta	Kandidatët nga komunitetet jo – shumicë 12%	Gjithsej
Programi Bujqësia Urbane / Urban Agriculture	18	2	20

Provimi pranues do të mbahet nga lëndët si në vijim:

1. Prodhimi në sektorin e hortikulturës
2. Pajisjet, makinat dhe ndërtimet në bujqësi
3. Trajtimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve
4. Sistemet e bujqësisë urbane
5. Ujitja dhe plehërimi i bimëve
6. Përpunimi dhe shpërndarja e produkteve ushqimore
7. Sipërmarrja dhe kërkesat urbane.

